



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVO			
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS-MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS AND DIASPORA-MINISTARSTVO INOSTRANIH POSLOVA I DIASPORË			
DIVIZIONI I ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTIT DHE ARCHIVIMIT-DIVIZIONI ZA ADMINISTRACIJO DOKUMENTA I ARHIVIRANJE			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	2-0	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	2436
Nr. Faqeve Br. Stanica No. Pages	04	Data Datum Date	01.07.2022
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspore
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pajtim me nenet 19 dhe 20 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, nenin 6 (paragrafi 1) të Rregullores nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ 02/2012 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidatëve për Nëpunës të Misionit Diplomatik, planin e Personelit 2022, si dhe duke u bazuar në vendimin e Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nr. prot. 2394 i datës 30.06.2022 për hapjen e konkursit për nëpunës të misionit diplomatik, më 01.07.2022, shpall:

KONKURS

Për 32 (tridhjetë e dy) zyrtarë të misionit diplomatik

Hapet konkursi për 32 (tridhjetë e dy) zyrtarë të misionit diplomatik si vijon:

- 1.1. **Dhjetë (10)** zyrtarë të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës angleze, nr.ref.01/ZMD – MPJD;
- 1.2. **Shtatë (7)** zyrtarë të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës frënge, nr.ref.02/ZMD – MPJD;
- 1.3. **Shtatë (7)** zyrtarë të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës gjermane, nr.ref.03/ZMD – MPJD;
- 1.4. **Dy (2)** zyrtarë të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës italiane, nr.ref.04/ZMD - MPJD
- 1.5. **Dy (2)** zyrtarë të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës spanjolle, nr.ref.05/ZMD – MPJD;
- 1.6. **Dy (2)** zyrtarë të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës arabe, nr.ref.06/ZMD – MPJD;
- 1.7. **Një (1)** zyrtar të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës greke, nr.ref.07/ZMD – MPJD;
- 1.8. **Një (1)** zyrtar të misionit diplomatik me njohuri të avancuara të gjuhës portugeze, nr.ref.08/ZMD – MPJD.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Mbështetur në nenin 32.1 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, nëpunësi i Shërbimit të Jashtëm ushtron me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara në përputhje me urdhrat, udhëzimet dhe rregulloret e Ministrisë së Punëve të Jashtme,

- mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës;
- mbron interesat e shtetit të Kosovës dhe të shtetasve dhe personave juridikë të Republikës së Kosovës në shtetin ose shtetin ku është akredituar dhe ushtron funksionet e tij;
- zbaton rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe siguron ruajtjen e të dhënave dhe informatave që i janë besuar;
- të pezullojë aktivitetin e tij në një parti, organizatë ose shoqatë politike gjatë periudhës në shërbimin e jashtëm;
- të mbajë, në të gjitha rrethanat, një qëndrim moral të denjë dhe profesional;
- të mos bëjë deklaratat që bien në kundërshtim me qëndrimin e Republikës së Kosovës në marrëdhënie me shtetet e tjera ose organizatat ndërkombëtare;
- t'i respektojë ligjet dhe rregulloret e shtetit ose të shteteve ku është akredituar dhe të mos përfshihet në veprimtari, të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit ose të shteteve ku e zhvillon veprimtarinë;
- të ushtrojë veprimtarinë e vet, në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i misionit diplomatik;
- të mos ushtrojë në shtetin ose shtetet ku është akredituar veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij ose të familjes së tij.

Kriteret për pranimin në shërbimin e jashtëm:

Në pajtim me nenin 19 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2012 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidatëve për Nëpunës të Misionit Diplomatik, kandidatët duhet:

- të kenë shtetësinë e Kosovës;
- të kenë aftësinë e plotë për të vepruar;
- të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- të mos jenë të dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- të mos kenë asnjë masë disiplinore të shqiptuar kundër tyre për përjashtim nga puna;
- të jenë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën;
- të kenë një kualifikim adekuat profesional;
- të zotërojnë në mënyrë të pranueshme dhe të përshtatshme një gjuhë të huaj për të punuar në shërbimin e jashtëm;
- të kenë kaluar provimin pranues të organizuar nga Ministria, ashtu siç përcaktohet në këtë udhëzim administrativ (Udhëzimi Administrativ nr. 02/2012 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidatëve për Nëpunës të Misionit Diplomatik).

Dokumentacioni:

Bashkë me flet aplikacionin, kandidati e dorëzon dokumentacionin në vijim:

- CV-në në gjuhën shqipe, serbe apo angleze;
- kopjet e diplomave dhe kualifikimeve të tjera akademike dhe profesionale (*diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i*);
- dëshmi nga Qendra për Punë Sociale se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
- dëshmi nga gjykata kompetente se kandidati nuk është dënuar për kryerje të veprës penale;
- dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë për ta kryer detyrën.
- **dëshmi të njohjes së gjuhëve të kërkuara në nivelin C1-C2 (e obliguar) ose studime universitare të kryera në njërën nga gjuhët e përcaktuara në këtë konkurs.**

Kandidatët e përzgjedhur sistemohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në njërën nga njësitë organizative të MPJD-së, deri në plotësimin e kushteve formale për dërgimin e tyre në misione diplomatike të Republikës së Kosovës dhe në vartësi të kapacitetit buxhetor.

Konkursi zhvillohet i veçantë për secilën nga pozitat e shpallura në këtë konkurs.

Parimet e pranimit të zyrtarëve të misionit diplomatik bazohen në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të komuniteteve, si dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë.

Pranimi kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive.

Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurimi të përgjithshëm, që përfshin një testim me shkrim dhe me gojë, si dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të vlerësimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Marria dhe dorëzimi i aplikacioneve

Aplikacionet mund të merren në uebfaqen e Ministrisë ose në ndërtesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, rr. "Luan Haradinaj", nr. 32, në Prishtinë.

Aplikacionet e plotësuar, së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, vërtetimet, referencat etj. të kërkuara, mund të dorëzohen:

- drejtpërdrejtë në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së dhe
- përmes postës fizike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë, nga dita e publikimit, dhe do të jetë i hapur nga data 01/07/2022 deri më 30/07/2022, në orën 16.00.

Për informata shtesë, mund ta kontaktoni në telefonin: 038 200 77 118, 038 200 77 112, 038 200 77 043, 038 200 77 073.

Konkursi është i publikuar edhe në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës: www.mfa-ks.net.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, siç specifikohet në ligj.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohen të aplikojnë për pozitat e shpallura.